

Thirrja nga data 23.03.2026 deri në datën 07.04.2026

TERMAT E REFERENCES

EKSPERT/E

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimin e punëtorisë.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI
Objektiva	Hartimi i strategjisë afatmesme të OJQ-së Nevo Koncept, me qëllim forcimin e kapaciteteve organizative dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga muaji Tetor të vitit 2025 ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit. Ky projekt synon të fuqizojë pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje përmes krijimit dhe funksionalizimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Asambleja Komunale e Fëmijëve përbëhet nga 45 anëtarë të zgjedhur nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në përbërje të saj janë të përfaqësuar komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian. Gjithashtu, në Asambleshë Komunale të Fëmijëve marrin pjesë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët kontribuojnë dhe angazhohen në aktivitetet e ndryshme që organizohen nga anëtarët e saj.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është një projekt i implementuar nga OJQ Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children në Kosovë dhe financuar nga Sida. Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, gjatë hartimit të politikave dhe organizimit të aktiviteteve komunale.

Në kuadër të projektit, është mbështetur krijimi dhe funksionalizimi i Asamblesë së Fëmijëve në nivel komunal, e përbërë nga nxënës të 13 shkollave fillore të mesme të ulëta në komunën e Prizrenit.

Përveç Prizrenit, projekti zbatohet edhe në komunat e Suharekës, Dragashit dhe Rahovecit, duke kontribuar në fuqizimin e zërit të fëmijëve dhe përfshirjen e tyre aktive në vendimmarrje në nivel lokal.

3. OBJEKTIVA

Objektiva e këtij aktiviteti është organizimi i punëtorisë për ngritjen e kapaciteteve të stafit të OJQ Nevo Konceptit, në kuadër të programit OCD, me fokus në forcimin e kapaciteteve organizative, planifikimin strategjik dhe zhvillimin e qëndrueshëm të organizatës.

Përmes kësaj punëtorisë, synohet që stafi të pajiset me njohuri dhe aftësi praktike për hartimin e dokumenteve kyçe strategjike, të cilat do të shërbejnë si udhërrëfyes për zhvillimin e organizatës në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Tema që do të trajtohen gjatë këtij procesi është:

- Hartimi i strategjisë afatmesme të OJQ Nevo Konceptit, duke përfshirë analizën e situatës aktuale, përcaktimin e vizionit, misionit, objektivave strategjike dhe prioriteteve të organizatës.
- Hartimi i planit të punës trevjeçar të OJQ Nevo Konceptit, në bashkëpunim të ngushtë me stafin e organizatës, duke përkthyer objektivat strategjike në aktivitete konkrete, të matshme dhe të realizueshme.
- Raportimi final: Përgatitja e raportit përfundimtar që përmbledh procesin e zhvilluar, rezultatet e arritura dhe dokumentet e hartuara, duke siguruar një bazë të qëndrueshme për implementimin e strategjisë në të ardhmen.

Përmes këtij procesi, Nevo Koncepti synon të rrisë efektivitetin e punës së saj, të përmirësojë planifikimin institucional dhe të fuqizojë rolin e saj në komunitet dhe në sektorin e shoqërisë civile.

4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti i angazhuar për hartimin e strategjisë afatmesme të OJQ Nevo Konceptit do të ketë për detyrë të udhëheqë procesin e planifikimit strategjik dhe të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionale gjatë gjithë angazhimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë përfshijnë:

- Hartimin dhe zhvillimin e metodologjisë së punës për procesin e planifikimit strategjik, duke përfshirë përgatitjen e materialeve të trajnimit dhe punëtorive.
- Facilitimin e sesioneve të trajnimit dhe punëtorive me stafin e OJQ Nevo Konceptit, duke siguruar pjesëmarrje aktive dhe gjithëpërfshirje në proces.
- Kryerjen e analizës së situatës aktuale të organizatës (analiza SWOT, vlerësimi i kapaciteteve organizative, etj.) si bazë për hartimin e strategjisë.
- Udhëheqjen e procesit të hartimit të strategjisë afatmesme, duke përfshirë definimin e vizionit, misionit, objektivave strategjike dhe prioriteteve të organizatës.
- Mbështetjen e stafit në hartimin e planit të punës trevjeçar, në përputhje me strategjinë e zhvilluar.

- Sigurimin që i gjithë procesi të zhvillohet në përputhje me politikat dhe procedurat e OJQ Nevo Konceptit.
- Ofrimin e komunikimit të qartë dhe profesional, si dhe interpretimin e saktë të informatave gjatë gjithë procesit.
- Përgatitjen dhe dorëzimin e raportit përfundimtar, i cili përfshin përmbledhjen e aktiviteteve, metodologjinë e përdorur dhe dokumentet e hartuara (strategjia dhe plani i punës).

5. AFATI KOHOR

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e programit të punëtorisë	Zhvillimi / adaptimi i programit të punëtorisë, përfshirë matralet e punëtorisë.	1	Prill 2026
2	Ofrimi i programit të punëtorisë për Stafin e Organizatës Nevo Koncepti.	Ofrimi i punëtorisë 3-ditor për stafin e Organizatës Nevo Koncepti.	3	Prill 2026
3	Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin	Hartimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin në punëtorinë mbi Hartimin e strategjisë dhe i planit të punës trevjeçar.	1	Prill 2026
	Gjithsej:		5	

6. REZULTATET E PRITSHME

- Strategjia afatmesme e OJQ Nevo Konceptit e hartuar dhe e aprovuar, e cila përfshin vizionin, misionin, objektivat strategjike dhe prioritetet e organizatës.
- Plani i punës trevjeçar i zhvilluar, i harmonizuar me strategjinë dhe i strukturuar në aktivitete konkrete, të matshme dhe të realizueshme.
- Ngritja e kapaciteteve të stafit të OJQ Nevo Konceptit në fushën e planifikimit strategjik dhe menaxhimit organizativ.
- Identifikimi i qartë i prioritetëve programore dhe fushave të ndërhyrjes për periudhën e ardhshme.
- Përmirësimi i planifikimit institucional dhe rritja e efikasitetit në implementimin e aktiviteteve të organizatës.
- Dokumentimi i procesit përmes raportit përfundimtar, i cili përmbledh metodologjinë e përdorur dhe rezultatet e arritura.

7. PROCEDURA E APLIKIMT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Metodologjia e propozuar e mbajtjes së punëtorisë.
- c) Dy (2) referencë.
- d) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.
- e) Oferten Financiare Bruto

Aplikimi duhet të dërgohet jo më larg se data 07.04.2026 në prokurimi@nevokoncepti.org